# Pyetje,Fakte dhe Mite mbi Vaksinën ndaj Gripit

I.Preza
Instituti i Shëndetit Publik
Programi Kombëtar i Vaksinimit
2018

# ÇFARË ËSHTË GRIPI?

- Gripi është një infeksion viral akut, i cili përhapet lehtë nga njeriu tek njeriu.

- Gripi sezonal është një problem serioz i shëndetit publik i cili shkakton gjëndje të rëndë shëndetësore, shtrime në spital dhe deri në vdekje tek grupet me risk të lartë.



# ÇFARË ËSHTË DHE SI VEPRON VAKSINA?

Vaksina ndaj gripit:

- përmban <u>pjesë inaktive</u> (virus të copëzuar jo të gjallë) të viruseve që mendohet se do qarkullojnë gjatë sezonit.

- Kundërtrupat fillojnë të zhvillohen në trup :
  - dy javë pasi është bërë vaksina.
  - mbrojnë ndaj infeksioneve nga viruset të cilat janë të ngjashme ose të njëjtë me ato me të cilat është prodhuar vaksina.

# Kush duhet te vaksinohet?

Vaksina ndaj gripit rekomandohet të kryhet:

- ❖ çdo vit,
- ❖ për çdo individ > 6 muajsh e lart,

dhe në vecanti për grupet e riskut:

- ❖ Gratë shtatëzëna,
- ❖ Të moshuarit > 60 vjec,
- ❖ Të sëmuret me sëmundje kronike
- ❖ Fëmijët e vegjël,
- ❖ Personeli shëndetësor.

# Kur duhet të vaksinohemi?

- Vaksinimi ndaj gripit duhet të kryhet përpara,në fillim dhe gjatë sezonit të gripit.
- Pra, për sa kohë që viruset janë në qarkullim vaksinimi mund të bëhet *gjatë gjithë sezonit te gripit*.

# A MUND TË JAPË VAKSINA MBROJTJE EDHE NËSE VAKSINA NUK KA NJË PËRPUTHJE TË MIRË?

- **PO,** kundërtrupat e zhvilluar në përgjigje të vaksinës ndonjëherë mund të sigurojnë mbrojtje kundër viruseve të ndryshëm të gripit që lidhen me njëri- tjetrin, pamvarësisht se nuk përputhet maksimalisht me viruset që qarkullojnë.


FACT
MYTH

# MITI SE: VAKSINA NDAJ GRIPIT SHKAKTON GRIPIN

## FAKT

- Vaksina ndaj gripit nuk mund të shkaktojë gripin pasi ajo nuk përmban asnjë virus të gjallë. Ajo përmban vetëm strukturat sipërfaqësore të virusit dhe jo pjesëzat infektuese të tij.

- Mendimi se vaksina shkakton gripin mund të lindë si rezultat i keqinterpretimit të ndodhive të lehta të padëshiruara të shkaktuara pas vaksinimit ose nga infeksionet respiratore të shkaktuara nga viruse të tjera, të cilat mund të shkaktojnë simptoma “të ngjashme si gripi”.

# MITI SE:VAKSINA NUK FUNKSION, UNË PRAPË U SËMURA ME GRIP!

**FAKT**

- Në 10 vitet e fundit,vaksina ka dhënë mbrojtje të mirë ndaj gripit dhe ajo është akoma mënyra më e mirë për të luftuar atë.

- Organizata Botërore e Shëndetësisë ka quajtur vaksinimin bashkë me ujin e pijshëm si dy ndërhyrjet që kanë impaktin më të madh tek njerëzimi. Vaksinimi funksion.

# MITI SE: VAKSINA NUK ËSHTË E SIGURTË

**FAKT**

- Vaksina është e mirë testuar dhe ka rezultate të shkëlqyera mbrojtëse.
- Ndodhi të pakëndshme të rënda nga vaksina ndaj gripit janë shumë të rralla.
- Ndodhitë më të zakonshme janë pak dhimbje dhe skuqje në vendin e injektimit, që kalojnë pas 1 deri 2 ditë, temperaturë e lehtë dhe kruajtje.

# Miti se:Një dietë e shëndetshme me shumë vitamina C e parandalon gripin.

**FAKT**

- JO, nuk ka efekt. Studime të shumta kanë treguar se vitamina C nuk ka asnjë ndikim në parandalimin apo kurimin e gripit.

# MITI SE:UNË KURRË NUK JAM SËMURUR ME GRIP, PRANDAJ NUK BESOJ SE DO MË ZËRË.

**FAKT**

- Gripi është një sëmundje që shkaktohet nga virusi i gripit dhe mund ti ngjitet kujtdo, pavarësisht se sa i fortë mund të jetë sistemi imunitar.
- Virusi i gripit pëson mutacione, si rrjedhojë vaksinimi i përvitshëm është mënyra më e mirë për të krijuar mbrojten e duhur ndaj tij.

# Miti se:Unë nuk bëj pjesë në grupet në risk.

**FAKT**

- Çdokush mund të sëmuret nga gripi.Ai mund t'ja ngjisë ndonjërit prej grupeve në risk (vulnerabël) edhe pa pasur ndonjë simptomë.
- Personeli shëndetësor është ndër grupet e shëndetshme që duke u vaksinuar mbrojnë jo vetëm vetveten, por edhe pacientët e të tjerët përreth.



# MITI SE: NJERËZIT E SHËNDETSHËM NUK E PËRCJELLIN GRIPIN

**FAKT**

- Rreth 70% e njerëzve që infektohen me grip nuk kanë simptoma dhe mund t'ja ngjisin sëmundjen të tjerëve(si. psh.grupeve në risk/personelit shëndetësor) edhe pse nuk ndihen të sëmurë.

# MITI SE: GRATË SHTATËZËNA NUK DUHET TË VAKSINOHEN NDAJ GRIPIT

**FAKT**

- Vaksina ndaj gripit nuk dëmton bebin e palindur-në fakt vaksinimi mbron si fetusin ashtu edhe gruan shtatëzënë.
- Vaksinimi mund të kryhet gjatë cdo tremestri të shtatëzënisë.



# Thuaji Gripit “JO”

